

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses, Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit E.A., kundër të paditurit, N.T.P. “C.F.L. t.” me seli në I., me NRB ..., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkoshëm, E.K., avokatë nga P., me objekt kontesti mospërmbushje të kushteve të kontratës, nëvlerë të përgjithshme prej 6,877.50 euro, në seancën kryesore publike të mbajtur më datë 26.09.2018, në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të përkoshëm të palës së paditur, ndërsa me datë 28.09.2018, merr këtë;

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si bazuar kërkesëpadia e paditëses, Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P..

I. DETYROHET e paditura N.T.P. “C.F. and L. t.” me seli në I., me NRB ..., që paditësit në emër të rimbursimit të mjeteve t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 6,877.50 euro (gjashtë mijë e tetë qind e shtëtdhjetëeshtatë euro pesëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, 08.11.2016, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit me detyrim.

II. Secila palë i mbartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., ka paraqitur padi me datë 08.11.2016, pranë kësaj Gjykate, kundër të paditurit N.T.P. “C.F. and L. t.” me seli në I., duke kërkuar që t’ia paguaj në emër të rimbursimit të mjeteve, shumën e përgjithshme prej 6,877.50 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 08.11.2016, e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata me aktvendimin III.EK.nr.538/16 të datës 29.01.2018 ka aprovuar propozimin e paditëses përcaktimin e përfaqësuesit të përkoshëm që i njëjti ti mbroj interesat e të paditurit, siç parashihet me nenin 79 paragrafi 3 të LPK-së.

I autorizuari i paditëses gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë duke kërkuar nga Gjykata, që ta detyroi të paditurinnë emër të rimbursimit të mjeteve t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 6,877.50 euro, sipas kontratës cila është nënshkruara nga e paditura, duke shtuar se paditësi në bazë të deklaratës së garancionit të sigurisë së ekzekutimit sipas policës nr.06079, si për garancioni për taksa të importit i ka dhënë të paditurit shumën prej 6,877.50 euro, e cila shumë është konfiskuar nga Dogana e Kosovës, pasi që i padituri nuk i ka përmbushur obligimet ndaj saj, andaj i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës ka mbetur pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paditësi ka lëshuar deklaratën garantuese dhe e kacekur se ky garancion ka vlefshmëri prej dt.24.04.2015 e deri me dt.23.04.2016 ndërsa siç rezulton nga transferi i bankës lëshuar nga R.B., transferi për Doganën e Kosovës është bërë me dt.04.08.2016, që do të thotë jashtë afatit për të cilën e ka lëshuar deklaratën garantuese, kështu paditësi ka vepruar në kundërshtim me deklaratën e saj garantuese edhe pse kërkesën e Doganës së Kosovës, e kishte pranuar me dt.22.04.2016, një ditë para kalimit të afatit të deklaratës garantuese ndërsa pagesën e ka bërë me vonesë mbi tre muaj, andaj ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor të kësaj çështje juridike ka administruar këto prova: inkasimi i garancionit bankar me nr.... e dt.22.04.2016, policia –deklarat për garancionin të sigurisë së ekzekutimit me nr.... , kontrata e dt.23.04.2015, akt marrëshja e dt.24.04.2015, certifikata e biznesit të të paditurit me nr.....

Pas shqyrtimit të detajuar të provave të administruara, shkresave të lëndës, thëniet e palëve, gjykata e ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në vështrim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, gjykata gjeti se:

Në mes palëve në procedurë nuk ishte kontestuese se kishin të lidhur kontratë me nr.... e datë 24.04.2015, për garancion bankar përkatësisht për taksa të importit sipas së cilës kontratë është depozituar shuma në emër të depos doganore në lartësi prej 6,877.50 euro, poashtu nuk ishte kontestuese në mes palëve në procedurë se kanë lidhur aktmarrëveshjen e datës 24.04.2015.

Kontestuese në mes palëve në procedurë ishte përgjegjësia për kthimin e shumën në emër të rimbursimit të mjeteve.

Gjykata ka gjetur se nga kontrata me nr.... e datë 24.04.2015 palët janë dakorduar në nenin 1 se siguruesi këtu paditësi ka lëshuar për të paditurën shumën prej 6,877.50 euro, në emër të garancisë për mbulim të përgjegjësive si depo doganore, poashtu në nenin 3 është përcaktuar se *“siguruesi ka të drejtën e rimbursimit nga debitori kryesor dhe/ose debitori solidar të çdo shume që ai bëhet përgjegjës të paguajë në përputhje me detyrimet e parashikuara në certifikatën e Garancisë”*.

Nga shkresa e Ministrisë së Financave e datës 22.04.2016 drejtuar këtu paditëses duke e njoftuar se Dogana e Kosovës ka bërë kërkesë për inkasimin e shumës prej 6,877.50 euro, për shkak të mos respektimit të procedurave doganore këtu nga i padituri.

Nga urdhëresa për transferin bankar të datës 27.09.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka bërë pagesën e shumës prej 6,877.50 euro, për doganën e Kosovës për dëmin përkatësisht për garancion të mos respektimit të procedurave doganore nga i padituri.

Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja e ka paguar shumën në emër të garancionit për mos respektim të procedurave doganore nga i padituri, Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 136 paragrafi 1 të LMD-së, në të cilin thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, andaj mbi gjendjen faktike të vërtetuar Gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e drejtë dhe e bazuar, andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditëses, respektivisht të autorizuarit të tij dhe kundërshtimet e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, Gjykata ju referua nenit 960 paragrafit 1 të LMD-së, sipas të cilit *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin*. Meqenëse nga provat e administruara u vërtetua se paditësja në emër të garancionit bankar ka paguar shumën prej 6,877.50 euro, si dhe të njëjtën shumë i ka inkasuar Doganës së Kosovës ashtu që e njëjta shumë duhet rimbursuar nga i padituri, prandaj Gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipër cituar dhe mbi gjendjen faktike të vërtetuar ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit së përkohshme të palës së paditur lidhur me atë se paditësi ka bërë pagesën me vonës mirëpo një pretendim të tillë Gjykata e refuzoj si të pa bazuar për faktin se kërkesa e dt.22.04.2016 e drejtuar nga Dogana e Kosovës, tek paditësi ka qenë brenda afatit të policës së garancionit meqenëse kërkesa ka qenë brenda afatit, lëshimi i urdhërit për pagesë nuk është relevante, po ashtu Gjykata vlerësoj edhe pretendimet tjera të të padituri por i konsideroj irelevante për të vendosur ndryshe në këtë çështje civile juridike, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me kthimin e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së, Gjykata e detyroi të paditurën që t’ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 8%, duke filluar nga data 08.11.2016, e deri në pagesën definitive, ndërsa lidhur me vendosjen për afatin parativ për pagesë në afatin kohor prej 7 ditëve, Gjykata e ka bazuar në nenin 509 pika e të LPK-së.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së.

Andaj, Gjykata bazuar në dispozitat e nenit 136 par.1, nenit 960 par.1 dhe nenit 382 paragrafi 1 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -Departamenti për Çështje Ekonomike

-

III.EK.nr.354/18me datë 28.09.2018

G j y q t a r j a

Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj Gjykate.